



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË BORDIT TË MONITORIMIT TË MEDIAS PËR DATËN
01.06.2019 DERI NË DATËN 19.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23 pika 1 germa "a" dhe neni 85, pika 2, 3 dhe 4 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Bordi i Monitorimit të Medias ka paraqitur në KQZ raportin e monitorimit nga data 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019. Raporti parashikon në mënyrë të detajuar, pasqyrimin që radiot dhe televizionet nën monitorim, i kanë bërë fushatës zgjedhore të zhvilluar në datat e mësipërme prej partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Ky raport përbëhet nga raporti i pasqyrimin të fushatës zgjedhore të ditëve të përfshira nga data 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019.



Nr. 853 i Vendimit Data 22 .06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias
për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019

Bordi i Monitorimit të Medias ka paraqitur raportin ku pasqyrohet minutazhi që çdo operator televiziv, që monitorohet nga BMM-ja ka patur në dispozicion për çdo parti politike në edicionet informative, në emisionet e tjera, në reklamat dhe spotet. Gjithashtu në mbështetje të nenit 85, pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 155 datë 07.05.2009 "Për përbërjen, mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit si dhe procedurat që ndjek Bordi i Monitorimit të Medias", BMM-ja në raportin e paraqitur ka propozuar edhe masat me kompensim në kohë televizive të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Gjatë monitorimit të javës së parë të fushatës për zgjedhjet vendore të 30 qershorit Bordi i Monitorimit të Medias ka konstatuar një moskonkordancë në publikimin nga mediat të vendimit të KQZ-së së datës 30 qershor për minutazhin e subjekteve zgjedhore.

Mediat vijojnë të publikojnë së bashku si aktivitetet zgjedhore të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 si Partia Socialiste, duke e përballur me aktivitetet e opozitës që nuk është regjistruar dhe nuk janë subjekte zgjedhore. Ka një përballje direkte të subjekteve zgjedhore me ata që nuk garojnë në zgjedhje.

Mediat audiovizive pasqyrojnë aktivitetet e zgjeruara të Partisë Socialiste si subjekt zgjedhor dhe të qeverisë. Menjëherë ato i përballin me qëndrime e deklarata të partive opozitare që nuk janë subjekte zgjedhore. Kjo është një situatë e pazakontë ku pasqyrimi i aktiviteteve të fushatës zgjedhore shoqërohet me zhvillimet ditore të aktualitetit politik jashtë saj.

Ka një mungesë të pasqyrimin të subjekteve të vogla elektorale, të cilat duke parë pasqyrimin në rrjete sociale nuk e kanë të përfshirë në televizion.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat progresive analitike që nga fillimi i fushatës dhe deri në ditën e raportit. Pasi ka monitoruar kohën e vënë në dispozicion të subjekteve zgjedhore nga operatorët radiotelevizivë Bordi ka arritur në këto përfundime:

1. TVSH

PS 200.91 min

Bindja Demokratike: 7.65 minuta

MEGA: 2.33 minuta

Partitë e tjera: 5.93 minuta

Bordi i Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

TVSH të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.



2. TOP CHANNEL

PS 235.96 minuta.

PSD: 4.07 minuta.

Bindja Demokratike: 1.17 minuta

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Top Channel të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

3. TV KLAN

PS 237.35 minuta

Bindja Demokratike: 9.82 minuta

PDS 0.57 minuta

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

TV Klan të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

4. VIZION PLUS

PS 287.86 minuta

Bindja Demokratike: 20 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Vizion Plus të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

5. ORA NEWS

PS 251.12 minuta

PSD 2.65 minuta

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Ora News të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta dhe Bindjen Demokratike.



Nr. 853 i Vendimit Data 22 .06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias
për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019

6. NEWS 24

PS 340.65 minuta

PDS 2.68 minuta

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

News 24 të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta dhe Bindjen Demokratike.

7. CHANNEL ONE

PS 136.82 minuta

PDS 0.47 minuta

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Channel One të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta..

8. ABC News

PS 757.08 minuta.

Bindja Demokratike: 21.28 minuta.

PDS 0.60 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

ABC News të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

9. TOP NEWS

PS 291.62 minuta.

PSD 8.50 minuta.

Bindja Demokratike 1.20 minuta.

PDS 1.10 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Top News të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.



Nr. 853 i Vendimit Data 22 .06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias
për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019

10. REPORT TV;

PS 259.37 minuta

Bindja Demokratike: 16.07 Minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Report TV të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

11. FAX NEWS

PS: 250.78 minuta.

Bindja Demokratike: 19.60 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

Fax news të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

12. A2

PS: 249 min

Bindja Demokraike: 0.80 min.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

A2 të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

13. RTSH Gjirokastra

PS: 517.57 minuta.

Bindja Demokratike: 62.07 minuta.

Mega 12.07 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

RTSH Gjirokastra të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.



Nr. 853 i Vendimit Data 22 .06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias
për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019

14. RTSH Korça

PS: 227.85 minuta.

Bindja Demokratike 27.45 minuta.

Bordi Monitorimit të Medias i propozon KQZ:

RTSH Korça të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektet politike PSD me 30 minuta.

Raporti i BMM nuk shoqërohet me masa administrative.

Në këto kushte KQZ vlerëson se në përputhje me me nenin 81, pika 2 dhe 84 këta operatorë duhet të kompensojnë partitë politike me minutazh shtesë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1 germa a, neni 81 pika 1 dhe 2, neni 84 dhe neni 85 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të urdhëroj operatorët **TVSH, Top Channel, TV Klan, Vizion Plus, Ora News, News 24, Channel One, ABC News, Top News, Report TV, Fax News, A2, RTSH Gjirokastra, RTSH Korca**, të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektin politik Partia Socialdemokrate me 30 minuta.
2. Të urdhëroj operatorët **Ora News, News 24**, të kompensojë në bazë të nenit 81, pika 1, subjektin politik Partia Bindja Demokratike me 30 minuta
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 853 i Vendimit Data 22 .06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Medias
për datën 01.06.2019 deri në datën 19.06.2019